



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Primjeto/Prodate Received/Delivery	19. 11. 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOM/SHK	6968/2023		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1217/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1217/2023, të datës 28.09.2023, të parashtruar nga ankuesi nga Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1217/2023, e datës 28.09.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi me numër Nr.16/2023, i datës 29.08.2023, i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

(tani e tutje referuar si ankuesi), kandidat në procedurën e rekrutimit për grupin “Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/ Mjekësisë”, gjegjësisht për pozitën “Inspektor i Shëndetësisë” në Ministrinë e Shëndetësisë, me datë 28.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Vendimin Nr.16/2023, të datës 29.08.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimin se i njëjti ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara për pozitën e shpallur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë



03.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, ndërsa, ky i fundit me datë 04.10.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6286/2023 të datës 28.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.16/2023 të datës 29.08.2023 të DMZP-së; Ankesën (pa datë dhe numër) të parashtruar nga ankuesi në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.10.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2023; Konkursin me numër reference RN00012041 të datës 11.07.2023; Vendimin me numër NR.02/161 të datës 25.09.2023; Listën e kandidatëve të aprovuar (pa datë dhe numër); Njoftimin datës 21.08.2023 lidhur me listën e ngushtë; Njoftimin e datës 29.08.2023 lidhur me plotësim ndryshimin e listës se ngushtë; Vendimin me numër Nr.05/2023 të datës 21.08.2023; Aplikacionin e datës 08.08.2023 të ankuesit se bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Dokumentin e identifikimit; Certifikatën shëndetësore të datës 11.05.2023; Licencën e punës të lëshuar me datë 26.01.2023 dhe me datë skadimi 25.01.2028; Diplomën universitare me numër 1118 të datës 08.09.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Mjekësisë, me të cilën dëshmohet se ankuesi ka përfunduar studimet master i Farmacisë; Certifikatën me numër 4932 të datës 24061990 të lëshuar nga drejtori i Boro-Ramizi; Certifikatën me numër serik: 733FB1DF7F14EB të datës 10.02.2023 të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Pasqyrën e Llogarisë Trustin për periudhën 08.03.2007 deri me 03.05.2023; Emalin e datës 08.11.2023 të drejtuar Emalin e datës 08.11.2023 të drejtuar

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, me datë 11.07.2023 (*afati për aplikim 01.08.2023 – 09.08.2023*) ka shpallur konkursin e jashtëm për praninë me numër të referencës RN0001204, për grupin *Specialistë të Përgjithshëm të Shëndetësisë/Mjekësisë*, në Ministrinë e Shëndetësisë, klasa profesional 1, 25 vende. Rrjedhimisht, sipas Vendimit Nr.05/2023 të datës 21.08.2023, rezulton se ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë për të vazhduar në fazën tjetër të procedurës për pozitën përkatëse të punës, me arsyetimin se i njëjti me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur dëshmitë e kërkuara sipas konkursit siç janë: kopjen e dëshmisë se punësimit së paku (2) dy vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura, kopjen e dëshmimeve të trajnimeve, si dhe kopjen e vetë deklaratimit me shkrim të nënshkruar se nuk ka në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.05/2023 të datës 21.08.2023, ka parashtruar ankesë pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa, kjo e fundit me Vendimin me numër Nr.16/2023, të datës 29.08.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën me arsyetimin e njëjtë se ankuesja nuk ka ofruar dëshmitë sipas konkursit, përkatësisht Kopjen e dëshmisë së punësimit se paku (2) dy vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura, kopjen e dëshmimeve të trajnimeve, si dhe përvoja e punës është e deklaruar në sektorin privat andaj nevojitet një vet deklaratim i nënshkruar se ankuesi nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, prandaj është vlerësuar se pala nuk i përmbush kushtet për përfshirjen në listën e ngushtë.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar Konkursin për grupin *Specialistë i Përgjithshëm i Shëndetësisë /Mjekësisë* pozitën “*Inspektor Shëndetësor*” dhe si pasojë si kërkesa të përgjithshme formale për këtë pozitë të punës janë përcaktuar:

- **Arsimi i kërkuar:** *Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në fushat; Mjekësi e Përgjithshëm, Mjekësi Tjetër dhe Menaxhim Mjekësore;*
- **Kualifikime të posaçme formale:** *Licenca pre ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore;*
- **Përvoja e punës e kërkuar:** *Se paku (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit arsimor, me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me Nr.1118, të datës 08.09.2005 me të cilën vërtetohet se i njëjti me datë 28.06.2005, ka përfunduar Fakultetin e Mjekësisë- Dega e Farmacisë në Universiteti i Prishtinës, nga rrjedhë se i njëjti ka plotësuar kriterin e vendosur në aspektin e kualifikimit arsimor. Ndërsa, sa i përket kriterit të përvojës së punës si dëshmi ka ofruar Pasqyrën e Trustit Pensional për periudhën kohore 08.03.2027 deri me 03.05.2023, sipas se cilës vërehet se ankuesit i janë paguar Kontributet Pensionale nga Nt.Sh Barnatore “AK-PHARM” nga janari 2007 e tutje; “People online” për periudhën dhjetor 2010, korrik 2012, korrik 2013, gusht 2013; PHARMAPLUS” për periudhën nëntor dhe dhjetor 2016, si dhe Ministria e Ekonomisë për periudhën mars dhe prill 2020. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, përvoja e punës në sektorin privat e provuar vetëm përmes pasqyrës së Trustit Pensional nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme nëse e njëjta nuk është e shoqëruara edhe me vërtetim/dëshmi nga punëdhënësi që specifikon edhe detyrat gjegjësisht angazhimin tij tek biznesi privat, standard ky tashme i vendosur nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, dhe i vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës, sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës.

Lidhur me kërkesën në klauzolën nr. 7 të Konkursit, përkitazi me vet deklarin se kandidati nuk ka një masë disiplinore në fuqi për lagim nga një pozitë e zyrtarit publikë, ankuesi në ankesën e tij pretendon së me rastin e aplikimit ka dorëzuar Vërtetimin e Odes së Farmacisteve, me të cilën dëshmohet se i njëjti nuk ka asnjë shkelje ligjore në kundërshtim me ligjin, ndërsa Këshilli për vendosje të drejt dhe meritore, ka kërkuar Konfirmim më shkrim nga DMZP-ja lidhur me dorëzimin e këtij dokumenti nga ankuesi, kurse ky i fundit përmes shkresës së datës 08.11.2023, ka ri konfirmuar së ankuesi nuk ka dorëzuar një dëshmi të tillë në procedurë të aplikimit, e të cilin dokument ankuesi nuk e ka ofruar as në procedurë të ankesës A.nr.1217/23.

Përkitazi me mos dorëzimin e certifikatave të trajnimeve, Kolegji sjell në vëmendje faktin se një kandidat mund të mos ketë trajnime të ndjekura dhe së trajnimet nuk paraqesin kusht të detyrueshëm formal dhe nuk përbejnë shkak për refuzim të aplikacionit, mirëpo, trajnimet kanë efekt vetëm në vlerësimin e Jetëshkrimit (CV-së).

Për sa me sipër dhe duke qenë se nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës, nuk e ka ofruar dëshmitë të vlefshme lidhur me përvojën e punës si dhe një vetë deklarin të nënshkruar nga vetë ankuesi se i njëjti nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozite e zyrtarit publik, pasi që i njëjti ka përvojë në sektorin privat. Andaj, Kolegji i Këshillit vlerëson se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ka vërtetuar drejtë gjendjen e fakteve dhe ka



zbatuar drejt ligjin material me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.05/2023 të datës 21.08.2023 dhe Vendimit Nr.16/2023, të datës 29.08.2023, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 15 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet së: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim.2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë...”*

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1217/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhuikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.